

**Raporti i Konferencës:**  
**Profilët Socio-Ekonomike të Komunave të Rajonit të Ferizajit**  
**Ferizaj, 6 tetor 2018**

*Ky botim është pjesë e programit të Konzortiumit të OJQ-ve (ATRC, KIPRED, BIRN, SPRC, KCBS dhe D+) "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm".*

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm"



*Përgatitur nga: Lulzim Peci, Mentor Agani, Diedon Nixha dhe Valdrin Ukshini.*

*Copyright © 2018, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) apo: +381 38 542 778.*

*Botuar nga:*



*Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)*

*Rr. Major Mehmet Bushi, H.III. No.1*

*10 000 Prishtinë, Kosovë*

*Telefoni dhe faksi: +381 38 542 778*

## HYRJE

Më 6 tetor 2018, në Ferizaj u mbajt Konferenca Rajonale me temë “Profilet Socio-Ekonomike të Komunave të Rajonit të Ferizajit”, e organizuar nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) me përfaqësues të udhëheqësive dhe asambleve komunale, si dhe të OJQ-ve të komunave të këtij rajoni. Në këtë konferencë u prezantuan dhe diskutuan gjetjet e punimit të KIPRED-it, “Komunat e Rajonit të Ferizajit: Profilet Socio-Ekonomike”<sup>1</sup>, që kishte për qëllim të përdoret si nxitje për hapjen e debatit publik, dhe t’u ndihmonte vendim-marrësve komunalë dhe kombëtarë në formulimin dhe zbatimin e politikave që do t’i adresojnë nevojat e popullatës rinore, dhe më në veçanti, të grup-moshës 15–29 vjet. Nga gjetjet e punimit dhe diskutimet e konferencës janë identifikuar këto çështje që kërkojnë trajtim urgjent nga autoritetet komunale dhe kombëtare:

- a) Ndryshimi i rregullativës ligjore për subvencionimin nga ana e komunave të aktiviteteve rinore, kulturore dhe sportive, që e parasheh vlerën prej vetëm 5 Eurosh për kokë banori, meqë për komunat e vogla kjo shumë është tejet e vogël për ngritjen e nivelit dhe të cilësisë së këtyre aktiviteteve në nivelin komunal;
- b) Infrastruktura e dobët apo inekzistente për aktivitete rinore, kulturore dhe sportive në Komunat e Kaçanikut, të Hanit të Elezit, Shtimes dhe Shtërpces, duhet të adresohet urgjentisht nga Qeveria e Kosovës, meqë me buxhetet e tyre modeste qeveritë komunale nuk do ta kenë mundësinë që atë ta përmirësojnë dukshëm në një periudhë afatmesme;
- c) Përgatitja e politikave lokale nga qeveritë komunale për fuqizimin e aktiviteteve rinore, kulturore dhe sportive në bashkëpunim me komunitetet rinore në pjesët urbane dhe rurale të komunave përkatëse të Rajonit të Ferizajit;

---

<sup>1</sup> *Komunat e Rajonit të Ferizajit: Profili Socio-Ekonomik*, KIPRED, Tetor 2018.  
([http://www.kipred.org/repository/docs/Profili\\_Socio-Ekonomik\\_-\\_Rajoni\\_i\\_Ferizajit\\_19397.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Profili_Socio-Ekonomik_-_Rajoni_i_Ferizajit_19397.pdf))

- d) Gjenerimi i të dhënave statistikore nga administratat komunale për punësimin, sektorin e punës dhe të bizneseve në nivelin lokal, për përcjelljen e trendeve ekonomike dhe përgatitjen e politikave për zhvillimin lokal, përfshirë këtu edhe punësimin e rinisë;
- e) Raportimi e rregullt periodik dhe vjetor i Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi para Asambleve Komunale për gjendjen e sigurisë në komunat e tyre, përfshirë këtu edhe nivelin dhe llojet e kriminalitetit, shfrytëzimin e narkotikëve, si dhe ekstremizmin e dhunshëm;
- f) Për shkak të dilemave dhe moskuptimeve në nivelin lokal është e nevojshme që Këshilli për Siguri i Kosovës ta bëjë sqarimin e terminologjisë juridike për:
  - 1. Luftëtarët e huaj terroristë;
  - 2. Personat që janë ndaluar para se të shkojnë në vatrat e luftës në Siri dhe Irak;
  - 3. Personat që kanë planifikuar dhe tentuar të kryejnë akte terroriste në Kosovë, në përkrahje të ISIS-it, Al Nusras, Al Kaidës dhe grupeve të tjera terroriste në Siri dhe Irak;
  - 4. Personat që kanë nxitur dhe planifikuar shkuarjen e individëve nga Kosova në vatrat e luftës në Siri dhe në Irak;
- g) Moskyçja e Komunës së Kaçanikut në autostradën Prishtinë-Shkup do të ketë pasoja afatgjate në zhvillimin e kësaj komune për shkak të izolimit nga infrastruktura moderne rrugore, gjë që do të ndikojë edhe në perspektivat e rinisë së këtij qyteti.

Për të pasur një ndërlidhje edhe më të mirë midis punimit të prezantuar dhe diskutimeve të zhvilluara në konferencë, ato do t'i përmbledhim sipas komunave përkatëse të rajonit të Ferizajit.

## Komuna e Ferizajit

Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Ferizajit, Znj. Kristina Gashi, theksoi se në nivelin parashkollor në Komunën e Ferizajit janë 1,545 fëmijë, në atë të mesëm të ulët 8,462, dhe në atë të mesëm të lartë 8,521 nxënës. Komuna e Ferizajit ka 49 shkolla, 39 prej të cilave janë fillore, tetë të mesme, dhe dy janë çerdhe publike, si dhe disa çerdhe jo-publike, me gjithsej 1,825 punëtorë, përfshirë këtu punëtorët arsimorë, administrativ, teknikë, dhe ndihmës.

Sa i përket rinisë dhe kulturës, sipas Gashit, Komuna e Ferizajit ka një bibliotekë publike, "Sadik Tafarshiku," bibliotekën ndërkomunale "Anton Çetta," katër biblioteka publike në fshatra, teatrin profesional "Adriana Abdullahu", si dhe festivalin e teatrove, ku çdo vit prezantohen tri premiera – shfaqje teatrore. Ndërkaq, sa i përket sportit, kjo Komunë ka pallatin e sporteve që mban emrin e ish-Presidentit amerikan Bill Klinton, stadiumin "Dardania", ndërkaq, stadiumi i qytetit që e mban emrin "Ismet Shabani" është në proces të rregullimit. Në këtë Komunë, sipas Gashit, janë aktive 42 klube sportive të disa fushave, si kick-boks, futboll, karate, xhudo, etj. Për më tepër, Komuna e Ferizajit ka shtrirje të teknologjisë informative prej 95%, me përjashtim të disa fshatrave si Dardania dhe Zllatari ku rrjeti është më i dobët.

Sipas Gashit, sa i përket strukturës sipas përkatësisë religjioze, 99% të popullatës së Komunës së Ferizajit janë të besimit islam, ndërkaq, 1% janë të besimit katolik, ortodoks dhe protestant. Sa i përket objekteve fetare, sipas informatave që Komuna i ka marrë nga Bashkësia Islame, Komuna e Ferizajit i ka 47 xhami aktive dhe 4 joaktive, një kishë katolike dhe gjashtë kisha ortodokse. Së fundi, sa i përket klerikëve fetarë, janë 47 imamë mysliman, një prift katolik, një prift ortodoks dhe një protestant.

Lidhur me nivelin e kriminalitetit, Gashi theksoi se në këtë mandat qeverisës është formuar edhe Këshilli për Siguri në Bashkësi që mban takime të rregullta, dhe se deri më tash nuk është evidentuar ndonjë rast i ekstremizmit të dhunshëm.

Në aspektin ekonomik, sipas Gashit, Ferizaji është një qendër e rëndësishme e biznesit në Kosovë. Komuna e Ferizajit është komuna e dytë pas Prishtinës për nga zhvillimi ekonomik, dhe sot ende funksionojnë fabrikat e dikurshme që edhe janë bazë për zhvillimin ekonomik të kësaj Komune.

Sa i përket buxhetit komunal dhe mbështetjes për aktivitete rinore, sipas Gashit, Komuna në vazhdimësi jep mbështetje për këto aktivitete. Për më tepër, sipas saj, udhëheqësit komunalë pothuaj çdo ditë marrin pjesë në këto aktivitete, të cilat mbështeten, si moralisht, ashtu edhe financiarisht, dhe gjatë vitit Komuna ndan buxhet prej afro 10 mijë Eurosh për aktivitete rinore, mjete këto që janë jashtë buxhetit të planifikuar komunal.

Ali Halimi, Këshilltar i Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin Komunal të Ferizajit, theksoi nevojën e trajtimit të problematikës së përdorimit të narkotikëve nga pjestarët e grupmoshës prej 15 deri në 29 vjet, një dukuri kjo jashtëzakonisht shqetësuese, të cilën ai e ilustroi me rastin e përdorimit të narkotikëve nga nxënësit e shkollave fillore. Sipas tij, në shkollën “Gjon Sereçi”, që është shkolla më e madhe në Kosovë me mbi 2.500 nxënës, në oborrin e saj edhe gjatë ditës mund të shihen të rinjtë duke konsumuar drogë.

Arian Imeri, Këshilltar i Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin Komunal të Ferizajit, theksoi se individët që kanë shkuar në vatrat e Luftës në Siri dhe Irak, nuk e kanë kuptuar që janë duke shkuar në një luftë terroriste, por kanë menduar se ajo është një luftë për liri, kështu që ata kanë qenë të nxitur nga ndjenja për t'i ndihmuar të tjerët.

Sipas tij, shteti duhet ta përdorë një strategji për t'i ndihmuar bashkësitë fetare, ashtu që ato vetë t'i organizojnë aktivitetet me të rinjtë, meqë, siç e theksoi, asnjë religjion nuk është i keq. Për më tepër, Gashi rekomandoi që Drejtoria e Rinisë me ekspertë të ndryshëm dhe me organizata rinore, duhet t'i zgjedhë temat që do të ishte dashur të trajtohen brenda një viti, dhe pastaj organizatat të aplikojnë me projekte, ashtu që të zgjedhen ato që do të kenë më së shumti ndikim tek të rinjtë. Sipas tij, nëse veprohet në këtë mënyrë, këto aktivitete do të kishin efekt tek rinia edhe përkundrejt shumës së vogël që dedikohet nga Kuvendi Komunal.

Xhavit Zariqi, Këshilltar në Kuvendin Komunal nga AAK, dhe zv. Ministër i Zhvillimit Ekonomik, i kontestoi të dhënat zyrtare të Agjencionit të Statistikave të Kosovës lidhur me papunësinë, duke theksuar se në Komunën e Ferizajit është vështirë të haset në persona të papunësuar. Për më tepër, ai theksoi se pjesa dërmuese e bizneseve në Komunën e Ferizajit kërkojnë punëtorë, dhe që mund të këtë të paimteresuar për punë, por jo edhe papunësi. Zariqi i kontestoi edhe të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës lidhur me popullatën rurale dhe urbane, duke theksuar që ky proporcion nuk është 60% me 40%, por përafërsisht 50% me 50%, meqë diferenca në listat e votuesve është rreth 200-300 votues. Ai më tutje shprehu edhe mospajtimin e tij me shprehjen "Luftëtarë të Huaj Terroristë" për individët nga Kosova që kanë shkuar në vatrat e luftës në Siri dhe Irak.

Fatlume Rexhepi (OJQ Vizionida – Ferizaj) theksoi që komunat e vogla të rajonit të Ferizajit administratën e kanë të stërngarkuar, ku 62% e mjeteve shkojnë për paga dhe mëditje. Sipas saj, sikur vetëm 1% nga buxheti i Komunës së Kaçanikut, që don të thotë rreth 27 mijë Euro, të shkonte për investime, kjo nuk do të ishte një shumë e vogël për subvencionimin e një klubi sportiv. Gjithashtu, sipas Rexhepit, është shqetësues edhe raporti i numrit të xhamive krahasuar me institucionet shkollore, meqë, për shembull,

në Komunën e Hanit të Elezit janë shtatë institucione arsimore dhe dhjetë xhami. Në këtë mënyrë, mund të konkludohet që infrastruktura fetare e BIK-ut po dëshmohej si më e fortë se ajo e institucioneve shtetërore të arsimit.



## Komuna e Shtimes

Nënkryetari i Komunës së Shtimes, z. Rrahman Jakupi, në fillim theksoi se Komuna e Shtimes tash është në procesin e hartimit të dokumenteve të ndryshme, si ai i strategjisë për zhvillim ekonomik, dhe të dokumenteve e planeve të tjera, dhe se gjatë përgatitjes së tyre të dhënat e prezantuara në “Profilin Socio-Ekonomik të Komunave të Rajonit të Ferizajit” do të merren parasysh.

Sa i përket ekstremizmit të dhumshëm, Nënkryetari Jakupi bëri disa vërejtje lidhur me të dhënat e Policisë së Kosovës, e cila kishte raportuar për dy raste të shkuarjes së individëve nga Komuna e Shtimes, edhe përkundrejt faktit që vetëm një person ia ka dalë të shkojë në Siri, ndërkaq, personi i dytë ka arritur vetëm deri në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë, ku nuk është lejuar të vazhdojë më tutje dhe është kthyer nga Policia e Kosovës. Sipas tij, shkuarja e këtyre individëve në Siri dhe Irak e ka dëmtuar në një masë mjaft të madhe imazhin e disa komunave në Kosovë, dhe sidomos atë të komunave të Rajonit të Ferizajit, dhe për këtë arsye nga aty po ikin edhe investitorët. Ai më tutje theksoi që Kuvendi Komunal i Shtimes nuk e ka trajtuar asnjëherë si pikë të veçantë ekstremizmin, mirëpo Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, për dallim nga viti i kaluar ka qenë mjaft aktiv, dhe se, fatmirësisht, gjatë viteve 2017 dhe 2018 nuk është shënuar asnjë rast i shkuarjes së individëve nga Komuna e Shtimes në vatrat e luftës në Siri dhe Irak.

Ruzhdi Jashari, Këshilltar Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, theksoi se në Komunën e Shtimes deri në vitin 2009 ka pasur shkolla në fshatra që kanë qenë të banuara, por sot në disa prej tyre nuk jeton pothuaj asnjë person. Këtë dukuri të lëvizjeve demografike, Jashari e ilustroi me shembullin e fshatit Llanishtë, që ka pak banorë, por nuk ka nxënës, dhe shkolla në këtë lokacion është mbyllur. Ai i përmendi po ashtu edhe fshatrat Topillë dhe Rancë, që kanë mbetur pa asnjë banor, si dhe fshatin Karaqicë që

është duke u shpopulluar krejtësisht. Për më tepër, ai theksoi se këto lokacione janë shpopulluar për shkak të moszhvillimit ekonomik, duke sugjeruar që zhvillimit rural t'i kushtohet kujdes më i madh ashtu që të ndërrohet kahu i këtyre lëvizjeve demografike.

Jashari në vazhdim theksoi se me një zhvillim ekonomik të mirëfilltë, dhe me një jetë kulturore më aktive, Komuna e Shtimes do të bëhej më e qëndrueshme, që gjendja e stabilitetit do të avanconte, dhe që, me këtë, shkaktarët e radikalizmit do të preheshin në rrënjë. Në këtë aspekt, sipas tij, kualiteti i shpërndarjes së mjeteve financiare nga buxheti komunal është në dorën e këshilltarëve komunalë dhe të njerëzve që marrin pjesë në vendim-marrje, dhe ai kërkoi aktivizëm më të lartë qytetar në aspektin e planifikimit dhe të shpërndarjes së mjeteve buxhetore.

## **Komuna e Kaçanikut**

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, z. Besim Ilazi, theksoi që buxheti komunal është buxhet i mbijetesës, dhe që mundësitë e komunave janë tejet të vogla, meqë granti i përcaktuar qeveritar është i pamjaftushëm për kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Ai më tutje theksoi se përmes organizatave që veprojnë në Komunën e Kaçanikut është kërkuar të ushtrohet një lloj presioni në nivelin qendror, dhe atë posaçërisht për investimet që janë shumë të domosdoshme, dhe pikërisht ato që janë të përqendruara në rininë. Komunës së Kaçanikut i mungon edhe një ambient i vetëm sportiv, ndërkaq, sa i përket subvencioneve, ai thekoi që vetë udhëheqja e Komunës, në fakt, është kritikuese e buxhetit komunal, meqë rregullativa qeveritare buxhetore e përcakton shumën e subvencioneve në vlerën prej pesë Eurosh për kokë të banorit. Në këtë mënyrë, Komuna e Kaçanikut me 34,000 banorë i ka në dispozicion 170,000 Euro për subvencione, e të cilat janë të dedikuara për bujqësi, rini dhe sport.

Sa i përket veprave kriminale, apo atyre penale, Kryetari Ilazi e bëri të ditur se është shënuar një rritje e tyre pikërisht për shkak të punimeve që ka pasur BechtelEnka, dhe se 60% e këtyre veprave penale janë të ndërlidhura me punimet që zhvillohen nga kjo korporatë.

Lidhur me ekstremizmin dhe radikalizmin, Kryetari Ilazi theksoi që Kaçaniku është etiketuar padrejtësisht me një term të tillë. Shifrat zyrtare të prezantuara në raportin e KIPRED-it sipas tij janë korrekte, mirëpo, janë edhe disa faktorë që pasqyrojnë të kundërtën, si, për shembull: territori i Kaçanikut nuk është shfrytëzuar si territor për trajnime, nuk ka pasur imamë të burgosur apo nën hetime, dhe, faktikisht, Kaçaniku nuk ka pasur asnjë element tjetër pos të rinjëve që kanë shkuar në vatrat e konfliktit në Lindjen e Mesme. Për më tutje, ai theksoi se Kaçaniku nuk mund të identifikohet si

kryeqytet i xhihadizmit, mirëpo mediat janë duke i dhënë tepër shumë publicitet kësaj çështjeje.

Nga ana tjetër, sipas Kryetarit Ilazi, si rezultat i veprimit të përbashkët që Komuna e ka pasur me Këshillin për Siguri në Bashkësi, si dhe punës për mirënjohje të Kryetarit të BIK-ut dhe të Komandantit të Policisë në ngritjen e vetëdijes së vetë qytetarëve, për fat të mirë në rreth katër vitet e fundit nuk ka qenë asnjë tentim për të shkuar në vatrat e luftës në Lindjen e Mesme. Këto rezultate, sipas tij, mund të konsiderohen si tejet pozitive, mirëpo niveli qendror duhet ta gjejë se cili ka qenë frymëzimi dhe motivimi i të rinjëve që kanë shkuar në vatrat e konfliktit në Lindjen e Mesme, duke mos përjashtuar këtu as faktorin ekonomik apo edhe faktorët e tjerë, gjë kjo që komunave do t'ju mundësonte parandalimin e kësaj dukurie. Sidoqoftë, sipas tij, mungesa e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm gjatë katër viteve të fundit, nuk don të thotë që ato nuk do të përsëriten në të ardhmen.

Më tutje, Kryetari Ilazi kërkoi që OJQ-të të ushtrojnë tryzni në nivelin qendror për zhvillimin ekonomik të kësaj komune, duke theksuar atë që gjendja ekzistuese ekonomike nuk mund të ndryshohet përnjëherë, mirëpo, me kapacitetet që i ka, niveli qendror të paktën do të mund të ofronte ambiente ku të rinjtë do të mund të zhvillonin aktivitete të ndryshme sportive dhe kulturore. Këto janë kosto që së bashku me nivelin qendror mund të përballohen, dhe kjo të rinjëve do t'u ofronte sado pak mundësi që përqendrimin ta orientojnë tjetërkund.

Komuna e Kaçanikut, sipas Kryetarit Ilazi nuk ka mbingarkesë administrative, meqë Komuna si organizatë buxhetore momentalisht ka 798 punetore, të përfshirë në veprimtaritë e shëndetësisë, të arsimit dhe të administratës. Kaçaniku ka mungesë të puntorëve të shëndetësisë dhe të administratës, mirëpo, nga ana tjetër, ka tepriçë të punëtorëve të arsimit, meqë buxheti ndahet për kokë nxënësi dhe nuk mund të

ndryshohet nga Komuna. Ai e theksoi faktin që në vendet me lartësi mbidetare të ulët, në 21.3 nxënës është një mësues, ndërkaq, në vendet me lartësi mbidetare më të madhe, ky raport është 14.8 nxënës për një mësues. Duke patur parasysh atë që Kaçaniku e ka një terren gjeografik shumë të ashpër, me fshatra në lartësi të madhe mbidetare, sipas tij, në këto lokacione ka klasë me nga 2 nxënës. Përderisa Qeveria e Republikës së Kosovës të mos e merr një vendim të ngjashëm me atë të Republikës së Shqipërisë, ku që nga 1 shtatori 2018 mësimi do të jetë i kombinuar, dhe nxënësit do të barten me transport të organizuar nga ana e komunës, sipas tij, kjo situatë do të vazhdojë të jetë e tillë. Nëse Qeveria e Kosovës e merr një kësi vendimi, kjo, sipas Kryetarit Ilazi do ta lehtësonte shumë gjendjen e tashme, meqë 55 punëtorë të arsimit në Komunën e Kaçanikut janë të tepërt, dhe kjo do ta krijonte mundësinë që ata të barten në vende të tjera. Sidoqoftë, edhe ky veprim, sipas tij nuk do ta mundësonte ndonjë zgjidhje lidhur me subvencionet, meqë rregullorja e parasheh vlerën prej vetëm pesë Eurosh për kokë banori, dhe, si e tillë, nuk e rrit shumën e subvencioneve. Kërkesa e Kryetarit Ilazi është që të rriten subvencionet, sepse, edhe po të hiqeshin shumat nga pagat për mësuesit tepricë, Komuna nuk mund t'i realojë ato mjete tek subvencionet, për shkak të kufizimeve ligjore që kanë të bëjnë me buxhetet komunale.

Shpend Krusha, Këshilltar i Kuvendit Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, theksoi se Komuna e Kaçanikut është ndër ekonomitë më të dobëta në Kosovë. Mirëpo, qyteza e Kaçanikut gjithashtu identifikohet edhe si vend historik në nivelin kombëtar, dhe jo vetëm në atë të Kosovës. Sipas tij, ekstremizmi fetar në Komunën e Kaçanikut është fryer më tepër në media, sesa që ka qenë në realitet. Në këtë mënyrë, është krijuar një bindje që në Kaçanik është një situatë e rrezikshme, gjë kjo që ka ndikuar edhe në situatën ekonomike. Krusha e ilustroi këtë me një eksperiencë personale, me atë të një kompanie ku ka shkuar për t'u furnizuar me mall, dhe pronarët e saj kanë menduar që

Kaçaniku është një vend ku zbatohet sheriat, e gjëra të ngjashme që nuk kanë të bëjnë me realitetin e Kaçanikut, por janë rezultat i imazhit të projektuar për të.

Më tutje, Krusha theksoi që rinia në Komunën e Kaçanikut është në një pozitë tejet të palakmueshme përfshirë edhe fenomenin e narkotikëve, dhe jo vetëm atë të ekstremizmit fetar, e që janë pasojë e krizës ekonomike në këtë komunë. Në anën tjetër, pos ndërtimit të infrastrukturës sportive, e cila është e pamjaftueshme, ai kërkoi që në aspektin institucional të organizohen edhe ligat e sporteve të ndryshme, meqë nuk mund të thuhet se është investuar në rini nëse ndërtohen dhjetë fusha sportive, pa bërë asgjë për organizimin e jetës sportive. Kjo, sipas tij, është e domosdoshme që të rinjtë të mos na devijojnë, dhe atë jo vetëm në drejtimin e ekstremizmi fetar, por edhe në drejtimet e fenomeneve të tjera negative.

Ai më tutje shtroi shqetësimin për moskryerjen e Komunës së Kaçanikut në autostradën Prishtinë–Shkup. Kuvendi Komunal i Kaçanikut në seancën e parafundit të muajit korrik 2018, ia ka parashtruar Ministrisë së Infrastrukturës një kërkesë që është votuar unanimit, për bashkangjirjen në autostradën e kombit e cila është gjashtë kilometra larg Kaçanikut, meqë me planin e tashëm 2/3 e popullatës së komunës nuk mund ta shfrytëzojnë atë autostradë në relacionin Kaçanik–Hani i Elezit. Kjo është edhe interes strategjik i komunës që ndikon edhe në ekonomi, meqë po të mos bëhet kjo, Kaçaniku praktikisht do të mbetet i izoluar, si gjeografikisht, ashtu edhe në aspektin infrastrukturor. Sipas tij, Kaçanikut i duhet lidhja përmes autostradës me Ferizaj, Han të Elezit dhe Shkup, sepse lidhjet familjare dhe të bizneseve të qytetarëve të Komunës së Kaçanikut janë të përqendruara kryesisht në këto tri vende. Nga ana tjetër, vizitorëve që në të ardhmen do të dëshirojnë të shkojnë në Kaçanik do t'u duhet t'i bëjnë edhe 30 kilometra shtesë për të arritur aty. Një lidhje e tillë, sipas Krushës, është jetike për të ardhmen ekonomike, dhe një qasje në autostradë në segmentin rrugor Kaçanik–Hani i

Elezit do t'i ndihmonte të dyja këto komuna që janë tejet të varfëra, kështu që, nëse kjo kyqje në autostradë nuk bëhet, varfëria në këto dy komuna do të rritet edhe më tepër.

## **Komuna e Hanit të Elezit**

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, z. Rufki Suma, fillimisht theksoi që Hani i Elezit është një komunë e re kufitare dhe rurale, dhe që kjo Komunë njëkohësisht është edhe qendër industriale, edhe pse jo aq sa ka qenë para luftës. Rënia ekonomike, sipas tij, ka ndodhur për arsye të shumta, mes tjerash për shkak të privatizimeve që janë bërë me vendime, qoftë të drejta, qoftë të padrejta, mbylljes së fabrikave, siç ishte rasti i fabrikës së azbestit, e cila ishte konstatuar si kancerogjene, dhe tash përdoret si terminal doganor, pastaj fabrikës së stiroporit, e cila kishte qenë fabrikë profitabile, por tash lirisht mund të quhet fabrikë familjare, etj.

Mes tjerash, Kryetari Suma i diskutoi zhvillimet si dhe problemet me të cilat ballafaqohet Komuna e Hanit të Elezit në fushën e arsimit. Kjo Komunë ka një shkollë të mesme që nuk i plotëson kushtet, dhe për këtë arsye nxënësit e zanateve dhe të profileve të ndryshme profesionale mësimet i vijnë në shumtën në Kaçanik. Sa i përket shkollave fillore, sipas tij, në Hanin e Elezit dhe në fshatrat e tij ato janë në gjendje jashtëzakonisht të mirë dhe të pajisura me mjete të teknologjisë informative. Mirëpo, në Komunën e Hanit të Elezit nuk ka çerdhe të fëmijëve, dhe atë jo pse Komuna nuk ka pasur mundësi që t'i ndërtojë ato, por për shkak se ajo nuk ka pasur pronë për ndërtimin e tyre. Pas kthimit të pronave të ish-armatës jugosllave në pronësi të Komunës, tash është ndërtuar një çerdhe, mirëpo, sipas Kryetarit Suma, fatkeqësisht, nga MASHT-ti nuk është marrë leja për funksionalizimin e saj. Ai e bëri me dije që është bërë kërkesë që të paktën me buxhetin e vitit 2019 të përfshihet funksionalizimi i kësaj çerdheje, duke theksuar që nëse nuk jipet leja ajo do të mbetet vetëm një objekt i pashfrytëzuar. Kryetari Suma e theksoi që një problem i veçantë në Komunë është cilësia e arsimit, meqë ka raste kur persona të caktuar nuk janë në gjendje ta përfundojnë as shkollën e mesme, duke përsëritur vite, dhe më pas dëgjohej që po të



njëtit kanë kryer fakultetin apo edhe masterin. Kjo, sipas tij, është pasojë e shndërrimit të arsimit në biznes, dhe të krijimit të një situatë ku kush ka para merr diploma. Qeveria komunale, sipas tij, është duke i bërë të gjithat që janë në kompetencat e saj, por për sa i përket cilësisë së përgjithshme të arsimit, ajo nuk ka ndonjë ndikim thelbësor.

Kryetari Suma më tutje theksoi që sporti dhe kultura janë ndihmuar me ato pak mjete që Komuna i ka patur në dispozicion, duke përmendur atë që në këtë Komunë nuk ka fshat apo shkollë që nuk ka fushë sportive. Po ashtu, për vitin e ardhshëm, Komuna ka paraparë që rreth 300 mijë Euro të orientohen për terrene sportive dhe për ndërtimin e një Shtëpie të Kulturës.

Mirëpo, sipas Kryetarit Suma, një fakt brengosës është ai që Hani i Elezit ka pasur terrene sportive, mirëpo Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në emër të eliminimit të azbestit, e ka dëmtuar pothuaj në tërësi fushën e futbollit të Komunës. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka dhënë mbi 1.3 milionë Euro për pastrimin dhe eliminimin e azbestit, mirëpo jo vetëm që azbesti nuk është pastruar, por, për më tepër, tash ai ka dalë dhe ka mbetur në sipërfaqe duke e rrezikuar jetën e qytetarëve. Me këtë çështje tash është duke u marrë edhe Policia, dhe Komuna e Hanit të Elezit për këtë edhe ka ngritur padi kundër Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Sa i përket shëndetësisë, Kryetari Suma theksoi se në Hanin e Elezit është vetëm një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare, duke shtuar që Komuna është përpjekur që qytetarëve t'u ofrojë trajtime dhe shërbime mjekësore. Kjo është bërë jo vetëm për banorët e Hanit të Elezit, por edhe për ata të fshatit kufitar Bllacë, ashtu që ata të gjitha shërbimet shëndetësore, apo edhe ato arsimore, t'i marrin në Han të Elezit. Mirëpo, për më tepër se një muaj vizitat shtëpiake janë ndërprerë dhe numri i punëtorëve është zvogëluar, meqë Qeveria e Kosovës nuk e lejon numrin e nevojshëm të punëtorëve

shëndetësorë. Në 4-5 vitet e fundit, sipas Kryetarit Suma, janë mbajtur punëtorë me kontratë mbi vepër ose përmes kontrateve me Caritas-in, mirëpo nga ky vit Qeveria nuk ka lejuar që bashkëpunimi me këtë organizatë të vazhdojë edhe më tutje, meqë është vlerësuar që Komuna është duke vepruar jashtëligjshëm. Si pasojë, Komuna është detyruar t'i largojë nga puna ata punëtorë shëndetësorë. Mirëpo, shton ai, tash është kuptuar që në disa komuna qendrat e mjekësisë familjare vazhdojnë të ndihmohen përmes Caritas-it, dhe se dihet që kjo varet nga interesat dhe përkrahjet nga niveli qendror, në kohën kur Komuna e Hanit të Elezit është e detyruar t'i ndërprejë vizitat shtëpiake pikërisht për shkak të mungesës së punëtorëve shëndetësorë.

Duke folur për ekstremizmin, Kryetarit Suma tha që Kosova është akuzuar padrejtësisht për të, edhe përkundrejt faktit që nuk mund të thuhet se nuk ka pasur raste të tilla. Mirëpo, sipas tij, kjo çështje është pak më specifike, dhe, si e tillë, duhet trajtuar në mënyrë më të veçantë. Në këtë aspekt, ai e shprehu papajtueshmërinë e tij me politikat e donatorëve. Sipas tij, donatorët japin donacione të shumta për luftën kundër ekstremizmit, mirëpo kur është në pyetje përfitimi i komunave nga ato donacione, atëherë mësohet që pikërisht komunat që ndoshta nuk e kanë patur asnjë rast të ekstremizmit të dhunshëm përfitojnë projekte të shumta, në kohën kur komunat që akuzohen për ekstremizëm nuk përfitojnë asnjë projekt, me përjashtim të ndonjë trajnimit apo konference, e tryezave të ndryshme, që përfundojnë me konkluzionet të kota që nuk kanë të bëjnë fare me realitetin. Pra, sipas Kryetarit Suma, për të përfituar, janë komunat e tjera që nuk kanë të bëjnë me ekstremizëm, ndërkaq, për tu akuzuar, janë Komuna e Kaçanikut apo e Hanit të Elezit, apo edhe ndonjë komunë tjetër. Për më tepër, ai theksoi se ka raste kur vijnë organizata në Komunë, dhe ofrojnë mjete vetëm për riparime, por jo edhe për ndërtim të infrastrukturës. Kjo, sipas tij, e paraqet vetëm një mashtrim, dhe është një politikë e gabuar që mundëson që në emër të luftës kundër

ekstremizmit organizatat e ndryshme të pasurohen duke marrë me mijëra apo edhe me miliona Euro.

Më tutje, Kryetari Suma e shprehu mospajtimin e tij me terminologjinë që përdoret për personat që kanë shkuar në Irak dhe Siri. Sipas tij, nuk duhet të lejohet që ata të quhen terroristë apo ekstremistë për shkak të asaj që ka ndodhur ndonjë rast, meqë, fundja, në Kosovë nuk ka ndodhur asnjë sulm terrorist. Ai këtë e arsyeton me rastet kur në vendet e tjera evropiane me sulme terroriste vriten nga 30–50, apo edhe më shumë njerëz, dhe ato vende nuk quhen qytete të xhihadizmit, ndërkaq, në rastin e Kosovës, ku 250 apo 300 persona i janë bashkangjitur konfliktit në Lindjen e Mesme, ajo konsiderohet si vendi që ka më së shumti ekstremizëm në nivelin rajonal. Kryetari Suma më tutje theksoi se vet fakti që mbi 250 persona janë kthyer prej Sirisë dhe Irakut, e bën të kuptohet që ata nuk janë pajtuar me luftën atje. Po ashtu, sipas tij, kur ka filluar lufta në Siri dhe Irak, institucionet tona kanë patur qëndrim tjetër, mirëpo tash, si Presidenca, ashtu edhe BIK-u dhe Qeveria janë tërhequr nga qëndrimi i tyre i mëhershëm. Kosova, si dhe vendet tjera kanë bërë ftesë që të luftohet Assadi. Ai mëton se duke pasur parasysh që edhe ne kemi qenë në luftë, dhe që edhe neve na kanë ndihmuar dhe përkrahur të huajt, një pjesë e atyre që kanë shkuar në Siri kanë menduar se janë duke i ndihmuar popullit të atij vendi që ka qenë i shtypur nga regjimi. Mirëpo, në momentin kur kanë shkuar atje, dhe e kanë kuptuar që nuk është duke u bërë një luftë e drejtë, por një luftë vëllavrasëse, shumica e tyre janë kthyer, dhe për këtë arsye nuk bën që të gjithë ata që janë kthyer t'i quajmë terroristë.

Për këtë, sipas Kryetarit Suma, nuk është dashur të pajtohen, as institucionet e Kosovës, dhe askush tjetër, dhe ata nuk duhet të quhen Luftëtarë të Huaj Terroristë, meqë njeriu nuk bën të quhet terrorist, vetëm pse ka shkuar në një shtet ku është zhvilluar lufta. Sipas tij, terrorist mund të quhet dikush për të cilin vërtetohet se ka bërë krime, ka bërë

akte terroriste, dhe jo vetëm pse ka shkuar dhe ka marrë pjesë në këtë luftë. Ai më tutje theksoi se nëse analizohet mirë kjo çështje, mund të thuhet që për ne Luftëtar i Huaj Terrorist mund të jetë një amerikan, gjerman apo italian, që vjen e lufton tek ne, meqë ai është i huaj. Mirëpo qytetari i Kosovës që merr pjesë, dhe është banor i Kosovës, nuk mund të jetë i huaj, dhe, për këtë arsye, kjo është një temë e veçantë me të cilën institucionet duhet të merren gjithsesi.

Sa i përket gjenerimit të statistikave të punësimit, Kryetari Suma vuri në dukje që Kumuna e Hanit të Elezit mund t'i bëjë ato. Mirëpo, këtu ka pengesa, meqë, për shembull, Komuna e di saktë kur një person vdes, meqë ajo i paguan shpenzimet e varrimit, mirëpo, edhe përkundrejt faktit që Komuna i dërgon të dhënat tek autoritetet përkatëse, për interesa politike të vdekurit e evidentuar nuk hiqen nga listat e votuesve, meqë në zgjedhje edhe ata "duhet të votojnë". Sipas tij, një sjellje të njëjtë institucionet e kanë edhe lidhur me ekstremizmin e dhunshëm, meqë kur përmendet fakti që në tre vitet e fundit asnjë person nuk ka shkuar në Siri, politika e Kosovës mundohet të tërhiqet duke thënë se 'nuk kemi raste'. Ai më tutje theksoi se para dy vitesh në Hanin e Elezit një person është dënuar për terrorizëm, dhe në media është raportuar që i njëjti ka dashur ta vras Papën, ndërkaq, personi tjetër që është arrestuar në Itali është liruar brenda ditës, meqë autoritetet e atjeshme kanë konstatuar që nuk ka asnjë fakt të prekshëm kundër tij. Sipas Kryetarit Suma, personi i arrestuar në Kosovë u shpall terrorist dhe u dënua me 7 muaj burg, ndërkaq, pas ankesës ai u dënua me 17 muaj, edhe pse nga ana tjetër figuron që në tre vitet e fundit nuk e kemi patur asnjë rast të bashkangjites ekstremizmit të dhunshëm.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizim"

